

V E N D I M
Nr. 509, datë 16.10.2002

**PËR RISHPËRNDARJEN E FONDEVE BUXHETORE TË VITIT 2002 NGA INSTITUTI I
SIGURIMEVE SHOQËRORE NË MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 të neneve 24 e 29 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të nenit 14 të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002" dhe të neneve 4 e 20 të ligjit nr. 8607, datë 27.4.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut" me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nga buxheti i miratuar për vitin 2002, në zërin "Pagesat e familjeve të Dëshmorëve të Atdheut", t'i pakësohet fondi prej 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh.
2. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, t'i shtohet ky fond prej 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh për shpenzimet administrative të Komisionit Qendror të statusit të Dëshmorit të Atdheut.
3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano